



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 506/3 Prot.

Tiranë, më 31. 07. 2023

### V E N D I M

**Nr. 149, datë 31. 07. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 59 Regj., datë 18.04.2023, nga subjekti ankues E. M., kundër Televizionit Syri Tv<sup>3</sup> dhe F. Q., moderator i emisionit “Kafe Shqeto” në televizionin Syri Tv, me pretendim diskriminimin për shkak të gjinisë dhe identitetit gjinor<sup>4</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Referuar pretendimeve të paraqitura në ankesë, subjekti ankues sqaron ndër të tjera se ka qenë i ftuar në emisionin e mëngjesit “Kafe Shqeto”, në televizionin Syri Tv, më datë 06.03.2023. Tema e emisionit ishte “Kush po i shtyn fëmijët drejtë komunitetit LGBT?”, duke iu referuar një sondazhi të kryer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Subjekti ankues pretendon se, është diskriminuar nga ana e përfaqësuesve të televizionit Syri Tv, pasi edhe pse ka qenë i ftuar në emision për të përfaqësuar komunitetin LGBTIQ+, është lënë i veçuar dhe nuk është lejuar të qëndrojë në studio me moderatorët. Ndërkohë, sipas subjektit ankues, mund të lidhej nëpërmjet platformave të komunikimit on-line (Skype etj.) dhe të mos ishte nevoja të paraqitej pranë televizionit Syri Tv.

Gjithashtu, subjekti ankues pretendon se moderatorin e emisionit, F. Q., gjatë zhvillimit të emisionit, i është drejtuar në gjininë mashkullore (L.), në vend të emrit që ka zgjedhur të përdorë për shkak të identitetit gjinor (L.). Këtë veprim, sipas pretendimeve të subjektit ankues, F. Q. e ka bërë në sensin e ironisë duke e kamufluar me humor.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Shoqëria “3D&AF Entertainment” sh.p.k.

<sup>4</sup> Subjekti ankues deklaroi se i përket komunitetit LGBTIQ+.

Përsa më sipër, subjekti ankues pretendon se F. Q., ka shkelur ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, duke fyer identitetin gjinor, mosrespektuar emrin, veçuar atë, si dhe duke përdorur ndaj komunitetit LGBTIQ+ gjuhë urrejtje. Gjithashtu, pretendohet se autorët e programacionit kanë censuruar videon e plotë të emisionit, duke tjetërsuar kontekstin e bisedës dhe fjalët e subjektit ankues.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për heqjen e videos së censuruar nga kanali Youtube, si dhe pranimin moral të diskriminimit nga moderatori F. Q. dhe autorët e emisionit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

*“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 506/1, datë 26.04.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar nga Syri TV dhe F. Q., që të paraqesin parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, si dhe të vendosin në dispozicion të shqyrtimit të çështjes një kopje e plotë në CD, të emisionit “Kafe Shqeto”, të transmetuar më datë 06.03.2023, në televizionin Syri Tv.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 443 708 415 AA, datë 26.04.2023 dhe RR 444 568 913 AA, datë 26.04.2023 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Syri TV dhe F. Q., të cilët ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

2. Në mungesë të përgjigjes së Syri TV dhe F. Q., nëpërmjet shkresës me nr. 506/2, datë 09.06.2023, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtesë për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e shkresës të paraqesin parashtrime mbi çështjen në fjalë.

Në vijim, Syri TV dhe F. Q., pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresën e sipërcituar, referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 445 751 218 AA, datë 09.06.2023 dhe RR 443 839 858 AA, datë 09.06.2023, nuk kanë depozituar asnjë informacion apo parashtrim lidhur me sa është kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje për të cilat janë ngritur pretendimet në ankesë, dhe, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Nga verifikimi i përmbajtjes së emisionit<sup>5</sup> të mëngjesit “Kafe Shqeto”, në televizionin Syri Tv, më datë 06.03.2023 në televizionn ABC News, rezulton se, në hyrje në emisionit, moderatori i emisionit ka prezantuar një material filmik lidhur me tematikën mbi të cilën do të diskutohej në vijim. Materiali filmik i referohej një studimi të kryer nga Gallup<sup>6</sup>, ku citohej ndër të tjera se numri i fëmijëve që kërkojnë të bëhen pjesë e komunitetit LGBT po rritet në mënyrë të shpejtë.

Evidentohet se moderatorët e emisionit kanë prezantuar të ftuarit e emisionit, përkatësisht, në lidhje direkte (jashtë studios), kanë qenë shtetasit: sociologu G. T. dhe përfaqësuesja e Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës, L. P. Gjithashtu, pak momente nga fillimi i emisionit, është prezantuar subjekti ankues, i ftuar në një studio paralele, si L., transgjimore, pjesë e komunitetit LGBT.

<sup>5</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=SFwf2WR22iw>

<sup>6</sup> Kompani globale analitike dhe këshilluese, e cila kryen studime dhe analiza në fusha të ndryshme.

Gjatë emisionit, nga të ftuarit, është diskutuar lidhur me: rritjen e numrit të fëmijëve të cilët po bëhen pjesë e komunitetit LGBT, faktin se si ndikojnë rrjetet sociale në mirërritjen e fëmijëve, kush po i shtyn fëmijët drejt LGBT?...etj.

Përgjatë emisionit evidentohen disa momente ku mes subjektit ankues dhe moderatorit të emisionit, F. Q. ka patur diskutime lidhur me reagimet e tij.

Në vijim të bisedës, moderatori, F. Q., i drejtohet subjektit ankues ndër të tjera se: “...*Edhe Balena Blu ishte fenomen i rrjeteve sociale, L. ose L. nuk e di...*”. Në këtë moment subjekti ankues i sqaron se duhet t’i drejtohet me L. dhe më pas zhvillohet biseda si më poshtë:

- F. Q., i sqaron se: “*Bëj shaka tani, pak sens humori në mëngjes, edhe transët duhet të kenë sens humori...*”.
- L.: “*O Flavio je gjithë ai inteligjent më Flavio me këtë humor të '92-shit*”.
- F. Q.: “*Jam 87-ta, mund të jetë edhe më i vjetër humori im*”.

Gjatë fjalës së mbajtur në emision, rreth minutës së ’30 të emisionit, zhvillohet sërish një diskutim mes subjektit ankues dhe moderatorit të emisionit, F. Q., si më poshtë vijon:

- L.: “*Orientimet seksuale kanë ekzistuar edhe nuk është një gjë që lindi tani dhe ne po i frikësohemi. D.m.th. të bësh seks është njësoj siç ti bën seks, pse duhet ta shikojmë si një gjë...ku ta di unë d.m.th....*”.

Në këtë moment F. Q. reagon duke bërë gjeste përmes mimikës së fytyrës. Një gjë e tillë bën që subjekti ankues të reagojë dhe ti drejtohet F. Q. duke i thënë: “*Këto reagimet e tua mo F. nuk i kuptoj d.m.th. Jemi njerëz mo vlla, kemi ndjenja. Ai lloj reagimi që ti bën, mund të jetë ofendues për mua dhe mund të lëndohem, mund të më shkaktoj trauma*”.

F. Q. i përgjigjet duke i sqaruar se: “*Nuk ka pse të të shkaktoj trauma humori. Humori në asnjë rast të njerëzimit nuk ka shkaktuar trauma.*”

L. vijon duke i thënë: “*Pse bën ato reagime se kam familje që më sheh. Pse familja ime duhet të shoh ato reagime që bën ti?*”.

F. Q. përgjigjet duke i sqaruar se: “*...është humor dhe mund t’ia thuash edhe familjes me gjithë dashamirësinë e mundshme*”.

Në mbyllje të emisionit teksa moderatori, F. Q. përshëndet të ftuarit, i drejtohet subjektit ankues duke e falenderuar dhe pyetur: “*L. M., faleminderit shumë për kohën..., zonja që të mos jem paragjykes dhe ofendues, si është përcaktimi? Zonja besoj...zonjusha?*”.

Subjekti ankues i sqaron se duhet t’i drejtohet me zonjusha pasi nuk është e martuar. Sakaq, F. Q. i drejtohet duke i kërkuar ndjesë dhe falenderuar sërish për kohën.

Vërehet se nga ana e drejtuesit të emisionit i është dhënë fjala secilit nga të ftuarit për të ndarë dhe shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me këtë temë diskutimi. Gjatë bisedës së zhvilluar evidentohet se mes subjektit ankues dhe moderatorit të emisionit ka patur diskutime në kuadër të humorit, duke iu drejtuar në mënyrë direkte njëri tjetrit. Megjithatë, në

përfundim të emisionit, subjekti ankues është falenderuar nga ana e F. Q. për pjesëmarrjen dhe kohën e gjatë së cilës ka marrë pjesë në emision.

Evidentohet se, nga ana e moderatorit i është krijuar hapësirë dhe mundësi të shprehin opinionet dhe mendimet personale secilit prej të ftuarave, si dhe t'i debatonin mes njëri tjetrit ato.

Nga ana tjetër, lidhur me pretendimin e subjektit ankues, lidhur me publikimin e censuruar të emisionit në kanalën Youtube të Syri Tv, Komisioneri nga verifikimi i publikimit të tij, ka konstatuar se, më datë 06.03.2023 është publikuar në kanalën e Youtube të Syri Tv. Nga konstatimi i bërë rezultoi se linku i përcjell në formularin e ankesës nuk gjendej edhe pas kërkimeve të realizuara nga Komisioneri. Në kanalën Youtube të Syri Tv, gjendej emisioni i plotë i mëngjesit “Kafe Shqeto” dhe nuk evidentohej se fjala e subjektit ankues ka qenë e censuruar apo e copëzuar. I gjithë diskutimi i realizuar nga pjesëmarrësit ishte i plotë në videon e publikuar në kanalën Youtube të Syri Tv. Gjithashtu, një fakt që u konstatua gjatë procedurave të shqyrtimit të çështjes ishte dhe filtrimi i komenteve të bëra në videon e publikuar. Evidentoheshin 2 (dy) komente të lëna poshtë videos së publikuar, por përmbajtja e tyre nuk ishte publike, ishte e mbyllur, duke shmangur në këtë mënyrë çdo komunikim apo komentim të mundshëm që mund të përmbante fjalë të papërshtatshme, fyese, denigruese, diskriminuese etj. Pra, në këtë kontekst, nga ana e Syri Tv masat parandaluese ishin marrë paraprakisht, në kanalën Youtube.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të subjektit ankues se është diskriminuar për shkak se është veçuar në një studio paralele dhe nuk ka qenë prezent në studio bashkë me moderatorët, u konstatua se gjatë serive apo emisioneve të tjera të mëngjesit “Kafe Shqeto”, janë konstatuar edhe raste ku të ftuarit kanë qenë në studio paralele si në rastin e subjektit ankues. Një rast që u evidentua nga ana e Komisionerit ishte emisioni mëngjesit “Kafe Shqeto”, realizuar më datë 08.05.2023, me temë “Shqiptarët e kërcënuar nga ushqimet”<sup>7</sup>, ku një prej të ftuarve ishte në studio paralele.

Pavarësisht pretendimeve të ngritura nga ana e subjektit ankues, Komisioneri gjykon se mënyra e pjesëmarrjes në emisionin televiziv objekt ankese, përcaktohet nga ana e strukturave përgjegjëse të tij apo përmes marrëveshjes mes palëve. Fakti që subjekti ankues nuk ishte në të njëjtën studio me moderatorët e emisionit, nuk konstatohet që të mos i jetë krijuar apo dhënë mundësia për të shprehur opinionet apo mendimet personale. Gjithashtu, evidentohet se në studio kanë qenë vetëm moderatorët e emisionit dhe nuk ka patur të ftuar të tjerë. I vetmi ndryshim apo trajtim i ndryshëm mund të ndodhte nëse subjekti ankues do të ishte në studion paralele, ndërkohë që të ftuarit e tjerë do të ishin në të njëjtën studio me moderatorët e emisionit.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, realizimi dhe transmetimi i emisioneve të tilla televizive dhe jo vetëm, është në funksion të qëllimeve dhe detyrës së vetë medias, me synim sensibilizimin e opinionit publik lidhur me publikimin e sondazheve apo studimeve të zhvilluara nga institucione të ndërtuara për këtë.

---

<sup>7</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=40Sjfa4POY0&t=531s>

Nga ana tjetër, e drejta e informimit, është një drejtë e publikut për t'u informuar dhe njohur me çështje dhe problematika me interes dhe shumë aktuale, siç mund të konsiderohet dhe çështja e diskutuar në emisionin, objekt gjykimi pranë KMD-së. Po ashtu mbetet detyrë e medias, që të përmbushë e realizojë këtë të drejtë të informimit të publikut, e po aq, dhe të transmetojë edhe opinionet dhe vlerësimet e individëve të ndryshëm lidhur me këndvështrimet e tyre për këtë çështje të shtruar për diskutim.

Ligji nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, është “rregullatori” i veprimtarisë së mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 4 të tij, ky ligj ka përcaktuar se:

*“1. Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve:*

- a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë;*
- b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve;*
- c) veprimtaria e transmetimeve audiovizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar;*
- ç) veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;*
- d) veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë”.*

Gjithashtu, ky ligj ka përcaktuar edhe se, operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parime si:

- “a) garantimi i lirisë së shprehjes;*
- b) garantimi i së drejtës së informimit;*
- c) ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit;*
- ç) respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private;*
- d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;*
- dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën;*
- e) garantimi i së drejtës së përgjigjes;*
- ë) garantimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të;*
- f) respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve;*
- g) respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe”.*

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet

të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup>.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14<sup>9</sup>, garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin Nr.12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin e të drejtave pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të tij, pra edhe për shkak të *gjinisë* dhe *identitetit gjinor*, si dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 3, pika 2, të LMD-së, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

LMD, në nenin 3, pika 8 e tij, ka përcaktuar se, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

---

<sup>8</sup> Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive*”.

<sup>9</sup> Neni 14, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Ndalimi i diskriminimit “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”.

Po ashtu, në pikën 13, të po këtij neni, ka përkufizuar “*Shqetësimin*”<sup>10</sup> si formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e mbrojtura, i cili ka për qëllim apo efekt cënimit e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>11</sup>.

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash, besimesh fetare dhe mënyrash jetese, ndonjëherë është e nevojshme që e drejta për lirinë e shprehjes të ekuilibrohet me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi. Arritja e kësaj mbrojtjeje, bëhet përmes balancës mes tyre, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një “shoqërie demokratike”.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjislacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Legjislacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes.

**Për këtë arsye, në analizimin që i është bërë përmbajtjes së emisionit “Kafe Shqeto”, datë 06.03.2023, në kontekst të pretendimit për censurimin e emisionit dhe përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, nga ana e moderatorit F. Q., dhe nëse do të konsiderohet në tejkallim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, si dhe mospërfshirja e subjektit ankues në të njëjtën studio me moderatorët; i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuara në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.**

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: “*Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë*

<sup>10</sup>“*Shqetësim*” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cënimit e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

<sup>11</sup> Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Në çështjen Handyside v. Mbretërisë së Bashkuar<sup>12</sup>, Gjykata bën një dallim mes një nxitjeje serioze për urrejtje apo stigmatizim dhe të drejtës së individëve për të shprehur këndvështrimin në mënyrë të lirë. Gjatë arsytimit të vendimit Gjykata është shprehur se: “...në funksionet e veta mbikëqyrëse e detyrojnë atë t’i kushtojë vëmendje të madhe, parimeve që karakterizojnë një “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie të tillë, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu. Është detyra e shtypit/televizionit, për të dhënë informacion dhe ide mbi çështjet politike, ashtu si mbi ato në fushat e tjera të interesit publik. Jo vetëm shtypi ka detyrën të japë informacione të tilla dhe ide, por po aq dhe publiku ka të drejtë për t’i marë ato (çështja Lingens kundër Austrisë, 1986)”<sup>13</sup>.

“Për median, veprimi në përputhje me standardet profesionale të pranuar duhet normalisht të përmbush testet më të arsyeshme”<sup>14</sup>. Gazetarët nuk duhen konsideruar përgjegjës për raportimin apo riprodhimin e deklaratave të të tjerëve, përsa kohë këto deklarata kanë vlerën e lajmit dhe gazetari përmbahet nga aprovimi i tyre. GJEDNJ ka nënvizuar nevojën për këtë përjashtim:

“Ndëshkimi i një gazetari për ndihmesën në shpërndarjen e deklaratave të bëra nga një person tjetër...do të dëmtonte rëndë kontributin e shtypit në trajtimin e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet parashikuar përveç rastit kur ka arsye të forta për të bërë. ...Një kërkesë e përgjithshme për gazetarët që sistemikisht dhe zyrtarisht të distancojnë veten e tyre nga përmbajtja e citimeve që mund të ofendojnë apo provokojnë të tjerët apo të dëmtojnë reputacionin e tyre dhe që nuk është në përputhje me rolin e shtypit për të fruar informacion mbi ngjarjet, opinionet dhe idetë aktuale”.

Në çështjen Jersild kundër Danimarkës (Kërkesa nr. 15890/89) GJEDNJ, u shpreh se dënimi i gazetarit përbente një shkelje të lirisë së shprehjes, mbi bazën se transmetimi ishte hartuar në mënyrë të tillë që të ekspozonte dhe analizonte qartë pozicionim e të të rinjve racistë dhe jo të promovonte këndvështrimin e tyre. Ishte një program serioz, që synonte një audiencë të mirë informuar dhe përbente një kontribut me vlerë për debatin publik. (paragrafet 33-35, të këtij vendimi të GJEDNJ-së).

“Gjuha e urrejtjes” kundër personave që i përkasin komunitetit LGBT, ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtij komuniteti. Vlerësimi

<sup>12</sup> Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976.

<sup>13</sup> Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976, paragrafi 49, përkthim i Komisionerit.

<sup>14</sup> GJEDNJ lidhur me çështjen nr. 21980/93 Bladet Tromso dhe Stensaas kundër Norvegjisë, paragrafi 65.

nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

“Gjuha e urrejtjes” për qëllim të Rekomandimit ECRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes, si: mbrojtja, promovimi apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin “raca”, ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, paaftësia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual<sup>15</sup>.

Ligji për Mediat Audiovizive garanton se aktiviteti i transmetimit i shoqërive të jetë në përputhje me të drejtën për informacion, e bindjeve politike dhe fetare, personalitetin, dhe dinjitetin si dhe me të tjera të drejta dhe liri themelore të njeriut. Transmetimi mediatik duhet të udhëhiqet nga parimet e “*moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve*”.

Ligji parashikon se shërbimi i mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të përmbajë asnjë nxitje ndaj urrejtjes mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare (Neni 32). Operatorët e shërbimeve audiovizive nuk lejohen të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi (Neni 76).

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive përfshin dhe përcakton parimet, rregullat, kushtet dhe praktikat për transmetimin audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar si instrument zbatues i ligjit Për Mediat Audiovizive në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/13 (“Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive”) dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si KEDNJ. Kodi përshkruan disa parime për shërbimet audiovizive midis të cilave janë dekurajimi i urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit për shkaqe të tilla si raca, gjinia, orientimi seksual, besimit politik (1.5); respektimi i së drejtës për barazi; dhe mosdiskriminim nga transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve (1.12).

Një zhvillim i fundit pozitiv në lidhje me vetë-rregullimin e mediave në internet është miratimi i Kodit të Etikës së Gazetarit<sup>16</sup> dhe Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online<sup>17</sup>. Kodi i Etikës së Gazetarit është hartuar nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (përfshirë gazetarët) në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore për Lirinë e Shprehjes dhe Mediave në Evropën Juglindore” (JUFREX).

---

<sup>15</sup> Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

<sup>16</sup> Kodi i Etikës së Gazetarit (2018) i disponueshëm në <https://kshm.al/en/about-us/code-of-ethics/> (30.4.2020)

<sup>17</sup> Udhëzime etike për gazetarinë online (2018) të disponueshme në: <https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/ETHICAL-GUIDELINES-FOR-ONLINE-JOURNALISM-7.pdf> (30.04.2020)

Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë, të njohura dhe të pranuara gjerësisht nga mediat dhe organizatat e gazetarëve në vendet demokratike. Ato përbëjnë gurin e themelit të pluralizmit demokratik dhe po ashtu respektojnë frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Liria e fjalës, liria e informimit dhe e kritikës, liria e shtypit, si dhe aksesit në dokumentet zyrtare përbëjnë elementët bazë të një shoqërie demokratike. Mediat luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në shoqëri, duke ofruar lajme e informacione të besueshme dhe në kohë, në forma të ndryshme dhe nëpërmjet platformash të larmishme.

Kodi i Etikës në frymë dhe nene, përcakton se, gazetarët duhet të bëjnë çmos për të ofruar raportim të paanshëm dhe të balancuar. Gazetarët gjithmonë duhet t'u referohen burimeve në dispozicion dhe palëve të interesuara që mund të ofrojnë informacion të dobishëm dhe të rëndësishëm për çështjen. Gjatë raportimit të një teme të debatueshme, gazetarët duhet të jenë përfshirës dhe të synojnë të sigurohen që të gjitha palët e interesuara të kenë mundësinë për të sqaruar pozicionin e tyre.

Ky Kod, ka shprehur në mënyrë të qartë se, është e një rëndësie thelbësore që, media të bëjë dallimin mes faktit dhe opinionit. Media duhet të bëjë qartë dallimin midis opinionit dhe raportimit mbi bazë faktesh. *Opinionistët, karikaturistët dhe kritikët janë të lirë të shprehin opinionet e tyre për ngjarje dhe persona.*

Lajmi lidhet me informacionin e mbështetur nga fakte dhe të dhëna, ndërsa opinionit përmban dhe shpreh ide, gjykime dhe vlerësime të gazetarëve, redaktorëve dhe botuesve.

Në kontekst të sa më sipër, Kodi i Etikës është një instrument vetë-rregullues i cili synon të drejttojë, forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri. Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë dhe respektojnë frymën e Kushtetutës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pika 8, e Kodit të Etikës përcakton se: *“Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës. Çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individi, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim”.*

Pika 9, e Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online (Udhëzimet) përmban një përkufizim të gjuhës së urrejtjes online sipas të cilës nënvizohet se: *“Gjuha e urrejtjes kuptohet si shprehje që kanë për qëllim të nxisin urrejtje të thellë, dhunë reale apo diskriminim ndaj individëve apo grupeve të caktuara, sidomos pakicave të çdo lloji”.*

Udhëzimet kanë parashikuar një sistem politikash për mbikëqyrjen dhe parandalimin e publikimit dhe komenteve që promovojnë gjuhën e urrejtjes. Mekanizmat e menaxhimit të përmbajtjes dhe mekanizmat e rishikimit të ankesave publike duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve. Sa i përket gjuhës së urrejtjes, redaktorët dhe operatorët e faqes në internet duhet të përdorin mekanizma efektivë për të identifikuar dhe çaktivizuar përmbajtje të tilla sa më shpejtë që të jetë e mundur. Udhëzimet e mësipërme janë gjithashtu të vlefshme deri në masën kur mund të jenë të zbatueshme, për faqet e rrjeteve sociale të mediave, duke marrë parasysh posaçërisht ndikimin e mundshëm të postimeve. Staf i përgjegjës për moderimin e komenteve duhet të trajnohet në mënyrën e duhur bazuar në legjislacionin përkatës kombëtar dhe standarde vendërkombëtare për mbrojtjen e grupeve të cenueshme. Gjithashtu, Udhëzimet përcaktojnë që redaktorët ose operatorët e faqes së internetit duhet të monitorojnë faqet e tyre të internetit (dhe faqet e tyre përkatëse të rrjeteve sociale) dhe të marrin masa për të parandaluar ose ndaluar publikimin e përmbajtjes të paligjshme, ose që cenon dinjitetin ose privatësinë e njeriut, ose përbën një gjuhë të urrejtjes.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri në këtë vendim është shprehur vetëm lidhur me pretendimin e subjektit ankues:

- kundrejt moderatorit të emisionit për shprehjen e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT dhe vetë subjektit ankues;
- kundrejt moderatorit dhe autorëve të emisionit, të cilët e kanë vendosur subjektin ankues në një studio paralele të Syri Tv;
- si dhe, kundrejt autorëve të emisionit, të cilët pretendohet se kanë publikuar atë të censuruar në kanalin Youtube;

Në konkluzion të analizimit të gjithë sa më sipër në vendim, Komisioneri vlerëson se, nuk evidentohet se trajtimi i problematikës së prezantuar në këtë emision dhe qëndrimi i mbajtur nga moderatori F. Q., të ketë të promovuar apo nxitur urrejtje ndaj personave që i përkasin komunitetit LGBT, as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të nënkuptuar dhe as me veprime apo mosveprime të tij.

Në analizë të informacionit dhe provave të vlerësuara, shihet se nuk ka qenë qëllimi i diskutimit, nxitja e urrejtjes apo qëndrimi diskriminues ndaj komunitetit LGBT apo subjektit ankues, por theksi i diskutimit është vënë tek domosdoshmëria për sensibilizimin e opinionit publik lidhur me temën e emisionit, si dhe ndikimin e rrjeteve sociale tek fëmijët.

Në këtë kuptim, qëndrimi i moderatorit gjatë emisionit dhe diskutimi i bërë me subjektin ankues, nuk evidentohet të jetë ndërtuar në kuadër të gjuhës së urrejtjes apo fyerjes së komunitetit LGBT apo edhe vetë subjektit ankues. Një fakt i tillë rezulton të jetë shprehur disa herë nga moderatori gjatë emisionit të zhvilluar. Në këtë kontekst, Komisioneri ka vlerësuar se, qëndrimi i mbajtur nga ana e moderatorit të emisionit, gjuha e përdorur prej tij nuk ka qenë fyese, apo të ketë patur qëllim apo nxitur urrejtje kundrejt komunitetit LGBT apo ndaj subjektit ankues. Komisioneri gjykon se, veprimet dhe qëndrimi i tij në raport me tematikën e trajtuar, si dhe debatin mes të ftuarave në këtë emision ka qenë në respektim të Kodit të Etikës së Gazetarit dhe të legjislacionit e jurisprudencës sipërcituar, përsa i takon paanshmërisë dhe balancimit të të drejtave të secilës prej të ftuarve për të ndarë dhe debatuar me njëri-tjetrin, por edhe për publikun opinionet e tyre personale.

Komisioneri, gjykon se, realizimi i emisioneve dhe trajtimi i temave të tilla, të debatueshme, megjithë pro-të dhe kundrat e tyre, i shërben qëllimit të përbashkët, evoluimit dhe përshtatjes së shoqërisë me realitetet e reja të krijuara.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka vënë theksin edhe mbi të drejtën e informimit të publikut, si një drejtë për t'u informuar dhe njohur me çështje të interesit aktual, siç mund të konsiderohet dhe çështja e diskutuar në këtë emision.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson si detyrë dhe qëllim të medias, përmbushjen e kësaj të drejte të informimit të publikut, e po atë, dhe transmetimin e opinioneve dhe qëndrimeve të individëve të ndryshëm lidhur me këndvështrimet e tyre për këtë çështje të shtruar për diskutim.

Megjithatë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shpreh keqardhjen lidhur me mosbashkëpunimin e Syri TV, përmes mosvendosjes në dispozicion të Komisionerit të materialit televiziv të emisionit të mëngjesit “Kafe Shqeto”, të datës 06.03.2023, referuar pikës 2, të nenit 32, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*. Gjithashtu, Komisioneri shpreh shqetësimin që në një hapësirë me qëllim informues, siç është në rastin konkret edhe emisioni i mëngjesit “Kafe Shqeto”, i realizuar në televizionin Syri TV, mund të ketë një masë të madhe keqinformimi, sidomos nga të ftuar të cilët nuk janë profesionistë të fushës.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se është diskriminuar për shkak se është veçuar në një studio paralele dhe nuk ka qenë prezent në studio bashkë me moderatorët, nuk konstatohet që të mos i jetë krijuar apo dhënë mundësia për të shprehur opinionet apo mendimet personale. Në studio kanë qenë vetëm moderatorët e emisionit dhe nuk ka patur të ftuar të tjerë. I vetmi ndryshim apo trajtim i ndryshëm mund të ndodhte në rastin nëse subjekti ankues do të ishte në studion paralele, ndërkohë që të ftuarit e tjerë do të ishin në të njëjtën studio me moderatorët e emisionit.

Lidhur me publikimin e emisionit në kanalin Youtube, Komisioneri ka konstatuar se mendimet dhe opinionet e subjektit ankues janë të plota dhe nuk janë të censuruara përsa ai pretendon në ankesë.

Gjithashtu, nga verifikimi i bërë në kanalin Youtube, lidhur me sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se opsioni i komenteve poshtë videos është i filtruar, duke bërë të pamundur teknikisht shfaqjen e komenteve të papërshtatshme, fyese, denigruese, diskriminuese etj. Pra, në këtë kontekst, nga ana e autorëve të emisionit masat parandaluese ishin marrë paraprakisht.

**Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se emisioni “Kafe Shqeto”, datë 06.03.2023, në televizionin Syri Tv dhe diskutimi i mbajtur mes subjektit ankues dhe moderatorit, F. Q., nuk ka patur për qëllim që të nxisë urrejtje apo të ketë patur qëndrim diskriminues lidhur me tematikën e trajtuar në të. Komisioneri vlerëson se, trajtimi i tematikave të kësaj natyre nga ana e mediave, është në koherencë me nevojën**

**e krijuar për sensibilizimin e opinionit publik dhe se debatimi i tyre në një shoqëri demokratike, i shërben të drejtës së publikut për t'u njohur jo vetëm me këtë realitet të ri, por edhe me qëndrime të ndryshme pro dhe kundër, gjithmonë pa gjeneruar nxitje të gjuhës së urrejtjes apo të motivimit nga një qëndrim diskriminues kundrejt komunitetit LGBT. Raste të tilla, kur mund të pretendohet një gjë e tillë, do jenë (sikurse kanë qenë dhe janë) objekt shqyrtimi rast pas rasti, nga Komisioneri.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja b), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjinisë dhe identitetit gjinor, nga ana e Shoqërisë “3D&AF Entertainment” sh.p.k.<sup>18</sup>, ndaj subjektit ankues dhe komunitetit LGBT.
2. Referuar diskutimeve të mbajtura gjatë emisionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon Televizionin Syri Tv dhe F. Q., në cilësinë e moderatorit të emisionit “Kafe Shqeto”, të mbajnë në vëmendje në të ardhmen dhe të tregohet më kujdes, që realizimi i temave sensitive në emisione të ndryshme, të zhvillohet në kuadër të informimit të publikut të gjerë dhe nga të ftuar profesionistë të fushave përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjinia dhe identiteti gjinor)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>18</sup> Si personi juridik përgjegjës për emisionin e transmetuar në televizionin Syri Tv dhe kanalën Youtube, me datë 06.03.2023.